

**VENDIM**  
**Nr.447, datë 13.7.2007**

**PËR RRIJTJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE, TË  
PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË TRAJTIMEVE TË VEÇANTA  
FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetësve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”, të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës bëhen të paafte plotësisht, pensionet suplementare familjare, pensionet suplementare familjare të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, dhe pensionet familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2007, përfshirë dhe kjo datë, të rriten në masën 3 për qind.

2. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, bëhen të paafte plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare familjare të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, të rriten në masën 3 për qind.

3. Trajtimi i veçantë financiar i pilotëve fluturues në pension të rritet në masën 3 për qind.

4. Trajtimi i veçantë financiar i efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues, të nëndetësve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension, të rritet në masën 3 për qind.

5. Trajtimi i veçantë i punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të rritet në masën 3 për qind.

6. Trajtimi i veçantë i punonjësve të disa ndërmarrjeve ushtarake të rritet në masën 3 për qind.

7. Rritjen, në masën 3 për qind, sipas pikave 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij vendimi, do ta përfitojnë të gjitha përfitimet e caktuara, me datë fillimi deri në 30.6.2007, përfshirë edhe këtë datë.

8. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 55 milionë lekë dhe të përballohen nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Institutin e

Sigurimeve Shoqërore.

9. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**